

## NË EMËR TË POPULLIT

### GJYKATA E QARKUT E GJILANIT

P. nr. 181/07

Data: 5 tetor 2010

Trupi Gjykses tre-anëtarësh i Gjykatës së Qarkut në Gjilan, i përbërë nga gjyqtari i EULEX-it Dragomir Yordanov si Kryetar i trupit, gjyqtarit të EULEX-it Vitor Pardal dhe gjyqtarit vendor Zyhdi Haziri si anëtarë të trupit gjykses, me asistencë të zyrtarit ligjor të EULEX-it Juhani Paiho si bashkëpunëtor profesional,

Në lëndën penale kundër Shefqet Musliu dhe Besim Tahiri, të akuzuar për veprën penale Rrëmbim i dëshmitarit FY sipas Nenit 64, paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit Penal të Serbisë lidhur me Nenin 22 të Ligjit Penal të RSFJ-së (Pjesa C e aktakuzës së ndryshuar),

Pas seancave dëgjimore publike të mbajtura me 1 shtator dhe 5 tetor 2010, kur është shpallur Aktgjykimi,

Në prezencën e të dy të pandehurve, së bashku me Prokurorin Publik Fahri Nuhiu nga PPQ në Gjilan, dhe mbrojtësit Masar Morina dhe Nikë Shala,

Pas Njoftimit të Kryeprokurorit të EULEX-it të parashtruar në Gjykatën e Qarkut në Gjilan me 04.10.2010, për tërheqje nga ndjekja penale kundër të pandehurve Shefqet Musliu dhe Besim Tahiri për veprë penale të sipërpërmendur,

Sipas udhëzimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës në Aktgjykimin AP 470/2004, të datës 27.03.2007,

Duke vepruar sipas Nenit 349, paragrafi 3 të Ligjit mbi Procedurën Penale, Gazeta Zyrtare nr. 26/1986, dhe sipas Nenit 357, paragrafi 5 të Ligjit mbi Procedurën Penale lidhur me Nenin 48, Paragrafi 3 të Kodit Penal të RSFJ (1976),

Nxjerrë këtë:

### AKTGJYKIM

#### 1. Refuzohet akuza kundër të pandehurve:

Shefqet Musliu, i lindur me 12.02.1963 në Konqul, Bujanoc, Serbi, i kombësisë shqiptare, me banim në Gjilan,

ish-komandant i Gjeneral-shtabit të UÇPMB-se, aktualisht duke e vuajtur dënimin në burgun e Dubravës, dhe

Besim Tahiri (me nofkën Çeçen), i lindur me 18.08.1980, i kombësisë shqiptare,

aktualisht duke jetuar në fshatin Doberqan, Kosovë,

për veprë penale Rrëmbim i dëshmitarit FY sipas Nenit 64, paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit Penal të Serbisë lidhur me Nenin 22 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste të Jugosllavisë (Pjesa C e aktakuzës së ndryshuar).

2. I pandehuri Shefqet Musliu (me shënime të lartcekura personale) dënohet me NJË DËNIM UNIK PREJ DHJETË VITESH E GJASHTË MUAJ ME BURG për veprat penale rrëmbim i dëshmitarëve 3, 4 dhe AK sikurse edhe për detyrim të tentuar të dëshmitarit 1, për çka më parë është dënuar me Aktgjykim të Gjykatës së Qarkut në Gjilan në lëndën P nr. 199/2003 të datës 25.06.2004 dhe dënimi është konfirmuar me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës AP 470/2004 të datës 27.03.2007.
3. I pandehuri Besim Tahiri (me shënime të lartcekura personale) dënohet me NJË DËNIM UNIK PREJ GJATË VITESH E NËNTË MUAJ ME BURG për veprat penale rrëmbim i dëshmitarëve 3 dhe 4, për çka më parë është dënuar me Aktgjykim të Gjykatës së Qarkut në Gjilan në lëndën P nr. 199/2003 të datës 25.06.2004 dhe dënimi është konfirmuar me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës AP 470/2004 të datës 27.03.2007.

## ARSYETIMI

### 1. Kompetenca e Gjykatës

Lënda bien nën kompetencat territoriale dhe lëndore të Gjykatës së Qarkut të Gjilanit ku është dërguar në rigjykim nga ana e Gjykatës Supreme të Kosovës. Për më tepër lënda bie nën kompetencë të gjyqtarëve të EULEX-it sipas Nenit 15 të Ligjit mbi Kompetenca.

### 2. Historiati procedural

Të pandehurit Shefqet Musliu, Besim Tahiri dhe Feriz Qerimi kanë qenë të dënuar nga gjyqtarët ndërkombëtar të UNMIK-ut në Gjykatën e Qarkut në Gjilan, me Aktgjykimin P.nr. 199/2003 të datës 25.06.2004, me sa vijon:

- Shefqet Musliu – për katër vepra të rrëmbimit të dëshmitarëve 3, 4, KA dhe FY me tetë vjet burgim për çdo njëërën prej veprave dhe për një veprë të detyrimit të tentuar të dëshmitarit 1 në dy vjet burgim me një dënim unik prej dymbëdhjetë vitesh.
- Besim Tahiri – për tri vepra të rrëmbimit të dëshmitarëve 3, 4 dhe FY me pesë vjet burgim për çdo njëërën prej veprave me një dënim unik prej shatë vitesh.
- Feriz Qerimi – për veprë të rrëmbimit të dëshmitarit FY me 5 vjet burgim.

Gjykata Supreme e Kosovës-gjyqtarë ndërkombëtar të UNMIKU-t, me Aktgjykimin AP nr. 470/2004 të datës 27.03.2007 të nxjerr pas ankesës së të pandehurve pjesërisht e ka konfirmuar Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut për sa i përket:

- Shefqet Musliu lidhur me tri vepra të rrëmbimit të dëshmitarëve 3, 4 dhe KA dhe të veprës së detyrimit të tentuar të dëshmitarit 1 me dënime përkatëse për çdo njëjërën vepër veç e veç;
- Besim Tahiri lidhur me dy vepra të rrëmbimit të dëshmitarëve 3 dhe 4 me dënime përkatëse për çdo njëjërën vepër veç e veç.

Me të njëjtin Aktgjykim Gjykata Supreme e Kosovës pjesërisht e ka prishur Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut për sa i përket veprës penale të rrëmbimit të dëshmitarit FY lidhur me tre të pandehurit dhe lidhur me dënimin e unik të Shefqet Musliut dhe Besim Tahirit si dhe e ka kthyer lëndën në rigjykim në Gjykatën e Qarkut në Gjilan së bashku me udhëzime.

Me Aktvendimin AP nr. 470/2004 të datës 10.03.2010 Gjykata Supreme e Kosovës korrigjoi Aktgjykimin e saj lidhur me një gabim të dukshëm material për sa i përket dënimeve të të pandehurve Shefqet Musliu dhe Besim Tahiri në pjesën e konfirmuar të Aktgjykimit.

Me Aktvendimin P. nr. 181/2007 të datës 01.09.2010 Gjykata e Qarkut në Gjilan pushoi procedurën penale kundër Feriz Qerimit për shkak të vdekjes së tij.

### **3. Ligji i aplikueshëm procedural**

Aktakuza e ndryshuar në këtë rast është paraqitur Gjykatës së Qarkut në Gjilan me 21.01.2004, para hyrjes në fuqi të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës, tani Kodi i Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) me 06.04.2004. Procedura penale është ende e pakryer në shkallën e parë për sa i përket veprës penale Rrëmbim i dëshmitarit FY pas Aktgjykimit të Gjykatës Supreme. Për këto arsye dhe sipas Nenit 550 KPPK-së, ligji procedural i aplikueshëm është Ligji mbi Procedurën Penale (LPP), Gazeta Zyrtare Nr. 26/86.

### **4. Konstatimet e Gjykatës**

#### **4.1. Lidhur me tërheqjen nga ndjekja penale**

Me 04.10.2010 Prokuroria Publike i paraqiti Gjykatës njoftimin për tërheqjen nga ndjekja penale kundër të dy të pandehurve për veprën penale me të cilën janë aktualisht të akuzuar (Rrëmbim i dëshmitarit FY), sipas Nenit 51 të LPP-së. Tërheqja ishte konfirmuar gojarisht nga Prokurori Publik në seancën dëgjimore.

Në këtë rast Gjykata është e obliguar sipas dispozitës së Nenit 349, paragrafi 3 të LPP-së dhe akuza në pritje të shqyrtimit për Rrëmbim të dëshmitarit FY sipas Nenit 64 paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit Penal të Serbisë lidhur me Nenin 22 të Kodit Penal të Republikës Federale të Jugosllavisë (Pjesa C e aktakuzës së ndryshuar) kundër të pandehurve Shefqet Musliu dhe Besim Tahiri do të refuzohet.

#### 4.2. Lidhur me dënimin unik

Pas heqjes dorë nga akuzat në lidhje me rrëmbimin e dëshmitarit FY dhe bazuar në udhëzimet e Gjykatës Supreme, Trupi Gjykues duhet të vendos mbi dënimin unik që do t'i shqiptohet të të pandehurve me sa vijon:

- Për sa i përket Shefqet Musliut – për tri vepra të rrëmbimit të dëshmitarëve 3, 4 dhe KA, për çdo njëërën vepër për të cilat është dënuar me tetë vjet burgim dhe për një vepër të detyrimit të tentuar të dëshmitarit 1 për çka është dënuar me dy vjet burgim dhe
- Për sa i përket Besim Tahirit – për dy vepra të rrëmbimit të dëshmitarëve 3 dhe 4, për çdo njëërën vepër për të cilat është dënuar me pesë vjet burgim

Ligji i ri penal ka hyrë në fuqi në vitin 2004, që do të thënë Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës tani është Kodi Penal i Kosovës (KPK), që nga kryerja e veprave penale nga ana e dy të të pandehurve në 2000-2002. Për këtë arsye dhe sipas Nenit 4 të Kodit Penal të RSFJ (1976) të aplikueshëm në kohën e kryerjes së veprave penale, trupi gjykues së pari do të vendos se cila prej tyre është më e butë për të pandehurit.

Dënimi unik është i rregulluar me Nenin 48 të Kodit Penal të RSFJ dhe me Nenin 71 të KPK. Sipas Nenit të parë (paragrafi 2, nënparagrafi 3), “*dënimi unik do të përbëhet nga dënimi më i rëndë i vlerësuar, por dënimi unik nuk mund të jetë më i lartë se totali i të gjitha dënimeve të shqiptuara, dhe nuk mund ta kalojë periudhën 15 vjeçare të dënimit me burg*”. Sipas nenit të dytë (paragrafi 2, nënparagrafi 2), “*dënimi unik duhet të jetë më i madh se çdo dënim i veçantë, por dënimi unik nuk mund ta arrijë shumën e të gjitha dënimeve të përcaktuara dhe as të tejkalojë periudhën prej njëzet vjetësh*”. Kështu Neni 48 të Kodit Penal të RSFJ është ligji më i butë penal që duhet të aplikohet gjatë përcaktimit të dënimit unik për të dy të pandehurit.

Me që Gjykata Supreme ka anuluar dënimin unik të shqiptuar me Aktgjykimin P nr. 199/2003 të datës 25.06.2004 pas ankesës të parashtruar vetën në emër të të akuzuarve, Gjykata është e obliguar me dispozitën e Nenit 390, paragrafi 4 së bashku me Nenin 378 të LPP, kështu që maksimumi i dënimit unik nuk do ta tejkalojë dymbëdhjetë vjet për Shefqet Musliun dhe shtatë vjet për Besim Tahirin.

Duke marrë parasysh kohën e kaluar që nga kryerja e veprave penale dhe fakti se dënimi i ri unik përmban një vepër më pak se dënimi i mëparshëm, Gjykata konstatoi se dënimi do të jetë më i ulët se dymbëdhjetë vjet për Shefqet Musliun dhe më i ulët se shtatë vjet për Besim Tahirin. Megjithatë, Gjykata gjithashtu konsideron se veprat e mbetura penale janë

të natyrës shumë serioze dhe paraqesin rrezik të veçantë publik për sa i përket dënimit të shqiptuar nga Gjykata e shkallës së parë dhe konfirmuar nga Gjykata Supreme e Kosovës. Duke marrë parasysh këta faktorë në kuptim të Nenit 41 të Kodit Penal të RSFJ, Gjykata i shqipton një dënim unik prej dhjet vitesh e gjashtë muaj për Shefqet Musliun dhe gjashtë vjet e nëntë muaj për Besim Tahirin.

Koha e kaluar në paraburgim dhe koha tashmë e vuajtur në burg nga ata sipas Aktgjykimit të Gjykatës Supreme (prej 07.07.2003 për Shefqet Musliun dhe 19.06.2003 për Besim Tahirin) do të llogaritet në dënimin unik sipas Nenit 351, paragraf 6 të LPP.

#### 4.3. Lidhur me paraburgimin e pretenduar të pandehurit Shefqet Musliu

Çështja është ngritur disa herë nga ana e mbrojtësit dhe është përgjigjur nga Gjykata sipas rregullit me një Aktvendim gjatë seancës dëgjimore me 01.09.2010 dhe para asaj me një letër të Kryetarit të trupit gjykues të datës 2 mars 2010. Sipas Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës AP nr. 470/2004 të datës 27.3.2007, faqe 3, paragrafi 5, *“Paraburgimi i të pandehurve Besim Tahiri dhe Shefqet Musliu do të mbetet bazuar në dënimet e shqiptuara në Aktgjykimet e konfirmuara.”*

Megjithatë, meqë për herë të parë është paraqitur si vërejtje në trupin gjykues se Shefqet Musliu, sipas tij, nuk përfiton nga të drejtat e të burgosurit në burgun e Dubravës, trupi gjykues konsideron se është e nevojshme të siguroj kopjet e dokumenteve të cilat i posedon (siç janë- Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës i datës 27.3.2010 AP nr. 470/2004, Procesverbalin e seancave dëgjimore të datës 01.09.2010 dhe 05.10.2010, si dhe tjera) për autoritetet e burgut të Dubravës për ta qartësuar statusin e tij si një person i burgosur.

#### 4.4. Lidhur me kërkesës për kthimin e sendeve të konfiskuara të pandehurit Shefqet Musliu

Gjykata konsideron se ekzaminimi i detajuar i shkresave të lëndës me qëllim që të vlerësohet se cilat nga sendet e konfiskuara janë të lidhur me veprat penale për të cilat të pandehurit janë shpallur fajtor, kërkojnë kohë shtesë për sa i përket madhësisë së dosjes dhe numrit të veprave penale. Për këtë arsye Gjykata konsideron se është adekuate që të bie një Aktvendim të veçantë për këtë çështje e cila do t'i komunikohet palëve sipas rregullit.

### **Gjykata e Qarkut në Gjilan, rasti P.nr. 181/07, 5 tetor 2010**

Dragomir Yordanov  
Kryetar i trupit gjykues  
Këshilla juridike :

Juhani Paiho  
bashkëpunëtor profesional

Ankesa mund te paraqitet kundër këtij Aktgjykim në Gjykatën Supreme të Kosovës. Ankesa e drejtuar Gjykatës Supreme të Kosovës duhet të paraqitet në Gjykatën e Qarkut në Gjilan brenda 15 ditëve nga dita e dorëzimit të këtij Aktgjykimi palëve (Ligji mbi Procedure Penale Neni 359 paragrafi 1).

Pala e dëmtuar, të cilës nuk i është dërguar thirrja për gjyq sipas rregullit për këtë shqyrtim gjyqësor, mundet që brenda 8 ditëve nga dita e marrjes së Aktgjykimit, të paraqes kërkesë për kthim në *status quo ante* nëse në atë kërkesë ai paraqet synimin e tij për ta rifilluar ndjekjen penale (Ligji mbi Procedure Penale Neni 61 paragrafi 2).

